

VENDIM
Nr.80, datë 21.1.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.646, DATË 30.9.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË POLICISË
SË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE TË SHPËTIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 2 të ligjit nr.8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.646, datë 30.9.2004 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Lidhja nr.2, e përmendur në pikën 2, shfuqizohet.
 2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“3. Numri limit i punonjësve të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, (më poshtë PMNZSH), në qarqe, të jetë gjithsej, 689 vetë.”.
 3. Në lidhjen nr.3, të përmendur në pikën 2, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Në organikën e stacionit të PMNZSH-së, Tiranë 1 (21 dhjetori), numri i punonjësve të personelit operues, luftues, shoferë, shpëtues policë bëhet 26 vetë.
 - b) Në organikën e stacionit të PMNZSH-së, Kavajë, numri i punonjësve të personelit operues, luftues, shoferë, shpëtues policë bëhet 11 vetë.
 - c) Në organikën e stacionit të PMNZSH-së, Durrës, numri i punonjësve të personelit operues, luftues, shoferë, shpëtues policë bëhet 18 vetë.
 - ç) Në organikën e stacionit të PMNZSH-së, Fier, numri i punonjësve të personelit operues, luftues, shoferë, shpëtues policë bëhet 21 vetë.
 - d) Në organikën e stacionit të PMNZSH-së, Berat, numri i punonjësve të personelit operues, luftues, shoferë, shpëtues policë bëhet 23 vetë.
 - dh) Në organikën e stacionit të PMNZSH-së, Vlorë nr.1, numri i punonjësve të personelit operues, luftues, shoferë, shpëtues policë bëhet 20 vetë.
 - e) Në organikën e stacionit të PMNZSH-së, Gjirokastrë, numri i punonjësve të personelit operues, luftues, shoferë, shpëtues policë bëhet 18 vetë.
 - ë) Në organikën e stacionit të PMNZSH-së, Korçë, numri i punonjësve të personelit operues, luftues, shoferë, shpëtues policë bëhet 18 vetë.
 - f) Në organikën e stacionit të PMNZSH-së, Elbasan, numri i punonjësve të personelit operues, luftues, shoferë, shpëtues policë bëhet 18 vetë.
 - g) Në organikën e stacionit të PMNZSH-së, Lezhë, numri i punonjësve të personelit operues, luftues, shoferë, shpëtues policë bëhet 11 vetë.
 - gj) Në organikën e stacionit të PMNZSH-së, Shkodër, numri i punonjësve të personelit operues, luftues, shoferë, shpëtues policë bëhet 22 vetë.
 - h) Në organikën e stacionit të PMNZSH-së, Peshkopi, numri i punonjësve të personelit operues, luftues, shoferë, shpëtues policë bëhet 14 vetë.
 4. Ngarkohet Ministri i Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha